


a JU trajtojnë
Në mënyrë të
BARABARTË
pa marrë parasysh
se të çfarë kombësie
apo feje JENI ?





përmbajtja

HYRJE...	4
TRAJTIMI I BARABARTË ËSHTË THEMELI KRYESOR I TË DREJTAVE TË NJERIUT...	7
MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI NË REPUBLIKËN SLOVENE...	10
PROCEDURA E SHQYRTIMIT PARA AVOKATIT TË POPULLIT	15
NORMAT NDËRKOMBËTARE QË E NDALOJNË DISKRIMINIMIN...	22
PROGRAMI KOLEKTIV I VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR DISKRIMINIMIT	34
PARAQITJA E ISCOMET-IT – MBARTËS DHE KOORDINATOR I PROJEKTIT EDUKIM DHE ARSIMIM PËR LUFTËN KUNDËR DISKRIMINIMIT NË SLOVENI...	36
ADRESA TË DOBISHME NË INTERNET	39
GRUPI I PROJEKTIT...	41



HYRJE

Bashkimi Evropian, në vitin 2000, mori masa për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit në shtetet e veta anëtare, mes të tjerave edhe zhdukjen e atyre formave, të cilat paraqiten për arsye të racës dhe prejardhjes etnike apo bindjes fetare të individit.

Bashkimi Evropian (BE) i besoi konsorciumit ndërkombëtar universitar dhe institucioneve të tjera nga Gjermania, Austria, Holanda dhe Sllovenia, të cilat i drejton ISCOMET - Instituti i Studimeve Etniko-Rajonale në Maribor, detyrën që për një afat prej 2 vjetësh të realizojnë projektin ndërkombëtar "Edukimi dhe arsimimi për luftën kundër diskriminimit në Slloveni". Qëllimi themelor i këtij projekti është që të përhapë dijet për këtë problematikë në Slloveni, të gjejë rrugën e duhur për zhdukjen e mungesave dhe përfundimisht të forcojë qëndrueshmërinë dhe pozitën ndërkombëtare të republikës sllovene brenda BE-së dhe veçanërisht marrëdhëniet me fqinjët. Mes të tjerave, në këtë projekt, kemi përfshirë dhe seminare të suksesshme me përfaqësues të pakicave etnike të pranuar dhe atyre jo të pranuar nga kushtetuta, me gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë, e gjithashtu edhe me anëtarë të policisë, ushtrisë sllovene, roje kufitare dhe të burgjeve.

Mes të tjerave, shtetet anëtare kanë për detyrë që t'ia arrijnë qëllimit për realizimin e normave evropiane, të zhdukin diskriminimin për shkak të kombësisë apo bindjes fetare, në përputhje me rregullat e brendshme juridike, masat e tjera përkatëse apo me politika të ndryshme. E rëndësishme është, veçanërisht, që kudo ku nuk ekziston kjo frymë demokratike, të krijojnë mundësitë që



të gjithë ata që mendojnë se kanë qenë viktimë të diskriminimit t'iu mundësohet qasja në rrugët e duhura ligjore për zhdukjen e padrejtësive. Qëllimi i këtij doracaku është që ta njohë lexuesin **në mënyrë të thjeshtë me dukurinë e të drejtave të njeriut dhe me atë që ndalimi i diskriminimit ose drejtësia ndaj trajtimit të barabartë është guri i themelit, në të cilin mbahet ndërtesa e madhe e të drejtave të njeriut.**

Lexuesit do të gjejnë këtu të gjitha ato informata, në bazë të të cilave do të njohin lehtë nëse dikush do t'i vejë në pozitë të ulët nëpërmjet ndonjë sjelljeje apo veprimi për shkak të kombësisë apo të bindjes së tyre fetare, e cila është në kundërshtim të plotë me normat juridike, të cilat përfshihen në aktet ndërkombëtare apo në legjislaturën e republikës sllovene.

Përkrah kësaj kemi përgatitur informata të shkurtra të procedurave vendore dhe ndërkombëtare, të cilat mund t'i përdorin viktimat e pabarazisë që të arrijnë zhdukjen e diskriminimit dhe të përfitojnë, nëse është me të drejtë, dëmshpërblimin e duhur për padrejtësitë që i kanë përjetuar. Në këtë doracak ofrohen edhe kontaktet e trupave vendore dhe ndërkombëtare, tek të cilët mund të kërkojë ndihmë ose të këshillohet kushdo që ka qenë viktimë e diskriminimit.


Sinqerisht, shpresojmë që me këto informata do të ndihmojmë sadopak në kufizimin apo zhdukjen e diskriminimit të banorëve të Sllovenisë, për shkak të kombësisë apo bindjes së tyre fetare. Krijimi i një mjedisi të ngrohtë shtëpiak për të gjithë banorët

e Sllovenisë, në të cilin do të ndjehen të sigurt, është i rëndësishëm për një zhvillim pa pengesa dhe të qëndrueshëm të republikës sllovene dhe për pozitën e saj në botë dhe veçanërisht në Evropë.

Në rrethana të tilla banorët e Sllovenisë do të mund të zhvillojnë në maksimum aftësitë e tyre krijuese, të cilat janë kushti kryesor për zhvillimin ekonomik, kulturor, njerëzor si dhe i drejtimeve të tjera në Slloveni. Nuk është e nevojshme që të theksojmë se grupi i vogël i bashkëpunëtorëve ISCOMET, (shiko në faqen e fundit adresën dhe hollësitë e tyre të kontaktit) është i gatshëm për çdo lloj informate tjetër, e cila do të ishte në ndihmë të viktimave të diskriminimit dhe të luftës së tyre për zhdukjen e padrejtësive, zbatimin e trajtimit të barabartë të njerëzve dhe respektimin e denjë njerëzor, pa marrë parasysh veçantërinë e tyre.

Prof. Dr. Silvo Devetak, drejtor i ISCOMET-it dhe drejtuesi kryesor i projektit ndërkombëtar





TRAJTIMI I BARABARTË ËSHTË THEMELI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Të drejtat e njeriut mund t'i quajmë si të drejta që i përkasin atij nga vetë natyra e që duhet t'i kishte fituar që në ditën e krijimit të vet. Vetia e tyre duhet të ishte universaliteti apo përshtatshmëria, e cila do të thotë se nuk kanë kushte kohore, rajonale apo shoqërore, por ato i përkasin çdokujt kudo që të ndodhet. Një nga të drejtat më të rëndësishme të njeriut është drejtësia e trajtimit të barabartë. Kjo do të thotë se, nëse zbatohet trajtimi i barabartë i të gjithë njerëzve, nuk ka diskriminim. Diskriminim do të thotë sjellje, e cila padrejtësisht e vë individin apo një shoqëri të caktuar në pozitë jo të këndshme, të ulët, qoftë në fushën ekonomike, shoqërore, politike ose në drejtime të tjera të jetës. Nga ana e drejtësisë dhe ajo juridike është i papranueshëm dallimi mes individëve ose grupeve të caktuara, pa ndonjë shkak të bazuar.

Mohimi i trajtimit të barabartë të individëve apo grupeve të caktuara shkel rregullat themelore, si të drejtësisë ndërkombëtare, ashtu edhe të legjislaturës slllovene dhe për këtë arsye është sanksionuar në mënyra të ndryshme. Që viktimat e diskriminimit të dinë t'i shfrytëzojnë apo përdorin të drejtat e tyre, patjetër duhet të njohin rregullat dhe mundësitë juridike, të cilat i janë vënë në përdorim. Në rast se në shoqëri ndodh diskriminim individual, dhe nuk merren masa për zhdukjen e tij, atëherë kjo potencialisht krijon një marrëdhënie politiko-shoqërore të paqëndrueshme.

Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, të cilën e ka aprovuar Organizata e Kombeve të Bashkuara në vitin 1948, e


cakton që në nenin 1, se **të gjithë njerëzit lindin të lirë, kanë denjësi të njëjtë dhe të drejta të barabarta**. Natyra iu ka dhuruar kuptimin dhe ndërgjegjen e duhet të sillen si vëllezër e motra me njëri-tjetrin. Përcaktimi fillestar e thekson qartë se asnjë person nuk është me shumë njerëzor se ndonjë tjetër dhe asnjë person nuk është më pak njerëzor se ndonjë tjetër. Të gjithë kemi të drejta të barabarta dhe që të gjithë jemi të njëjtë para ligjit.

Barazia nuk do të thotë se jemi identikisht të njëjtë. Mes njerëzve ekzistojnë dallime si në pamjen e jashtme, ashtu edhe në karakter: çdo njeri është i veçantë dhe i papërsëritshëm. Ky është fakt i rëndësishëm, sepse pikërisht veçantia ose dallueshmëria është esenca e shoqërisë njerëzore dhe ekzistencës së saj. Dallimet e sipërpërmendura mes individëve apo grupeve të caktuara nuk lejohet që të shkaktojnë sjellje, të cilat do të ishin bazuar në bindjen se ndonjë individ apo grup është më i mirë ose më i keq se ndonjë individ apo grup tjetër vetëm për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, seksit (femër, mashkull), bindjes seksuale (homoseksualët, etj.), gjuhës, invaliditetit, fesë, bindjes politike, prejardhjes kombëtare apo shoqërore ose për shkak të rrethanave personale. Nëse vjen deri tek pabarazia për arsye të fakteve të sipërpërmendura, kjo do të thoshte diskriminim i ndaluar.

Nëse kërkesa për një punësim do të përmbante kushte të tilla si p.sh.: *‘...nëse kandidatët janë invalidë, të huaj apo homoseksualë, nuk mund t’iu bëhet i mundur punësimi...’*, kemi të bëjmë me

një shenjë të dukshme të diskriminimit. Gjithashtu diskriminim është nëse dikë e thërrasim me fjalë fyese ose pseudonime, vetëm për shkak të ngjyrës së tij/saj të lëkurës, moshës (plakush, picirruk...) seksit (femër, mashkull), etj. Por, në dallim me diskriminimin e drejtpërdrejtë, sjelljet e sipërpërmendura shpesh shfaqen në formë të diskriminimit subjektiv, jo të drejtpërdrejtë, në mënyrë që edhe vetë viktimat ta dallojnë me vështirësi. Andaj, ky lloj diskriminimi është i vështirë që të luftohet.

Nëse dikush nuk mund të punësohet ose të përfitojë diçka që dëshiron, kjo nuk do të thotë se është i diskriminuar. Por, kur shihet qartë se punëtorëve me moshë të kaluar asnjëherë nuk iu jepet mundësia për punësim apo invalidëve nuk iu jepet mundësia që të bien në kontakt me institucionet publike apo që të marrin pjesë në shoqata të ndryshme, mund ta pyesim veten se a është kjo vetëm një rastësi apo kemi të bëjmë me diskriminim të mbuluar.




MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI NË REPUBLIKËN SLOVENE

Kushtetuta e republikës slovene (RS) shqyrton parimin e barazisë dhe ndalon diskriminimin dhe e mban këtë dekretligj si një nga më të rëndësishmit për të drejtat e njeriut. Aktet themelore për sovranitet dhe pavarësi të republikës slovene në pikën III theksojnë, se RS-ja garanton sigurimin e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore të të gjithë personave në territorin e RS-së pa marrë parasysh se cilës kombësi i përkasin, pa asnjëfarë lloj diskriminimi në përputhje me kushtetutën e RS-së dhe me marrëveshjet e vlefshme ndërkombëtare.

Kushtetuta në nenin 14 shqyrton si vijon:

"Në Slloveni çdo njeriu i janë të garantuara të drejtat e barabarta dhe liritë themelore, pa marrë parasysh kombësinë, racën, seksin, gjuhën, fenë, bindjen politike apo tjetër, gjendjen materiale, lindjen, arsimimin, pozitën në shoqëri apo çdo rrethanë tjetër personale. Të gjithë, para ligjit, jemi të njëjtë".

Krahas nenit 14, gjëjmë shqyrtime për ndalimin e diskriminimit edhe në nenet e tjera të kushtetutës. Sipas kushtetutës gjykohet se RS-ja garanton mbrojtje të gjerë kundër të gjitha formave të pabarazisë, dallimeve dhe gjerësisht përmbledh apo më mirë përcakton parimin themelor, si edhe rregullat e barazisë para ligjit, barazinë dhe ndalimin e diskriminimit në seanca të veçanta të caktuara, ndalon përkrahjen e diskriminimit dhe nxitjen e urrejtjes racore apo të formave të ngjashme të urrejtjes dhe i garanton të drejta të veçanta individit apo grupeve të caktuara për të arritur qëllimin e trajtimit të barabartë.



Në bazë të kushtetutës kanë qenë aprovuar disa akte ligjore dhe nënligjore, qëllimi i të cilave është ndalimi i pabarazisë dhe diskriminimit në jetën e përditshme.

Si ligj themelor për luftën kundër diskriminimit mund të nënvizonim **Ligjin për zbatimin e parimit për trajtimin e njëjtë** (ZUNEO, Ur. I. RS št. 50/04).

ZUNEO duhej që në përputhje me kryerreshtin e nenit 1, me shfrytëzimin e të drejtave e të detyrimeve të tij, me realizimin e lirive të tij themelore, të garantonte **trajtimin e njëjtë të çdo njeriu në çdo drejtim të jetës shoqërore**, veçanërisht në drejtimet e punësimit, marrëdhënieve punësore, përfshirjen në sindikata dhe shoqata me interesa të ndryshme, edukimit dhe arsimimit, sigurimit social, të drejtave ndaj të mirave materiale dhe përkujdesjes për to, **pa marrë parasysh rrethanat e tij/saj personale**, siç janë kombësia, raca ose prejardhja etnike, seksi, gjendja shëndetësore, invaliditeti, gjuha, bindja fetare apo bindje tjetër, moshë, drejtimi seksual, arsimimi, gjendja materiale, pozita e tij/saj në shoqëri apo rrethana të tjera personale.



Forma të ndaluara të diskriminimit janë:

1. DISKRIMINIMI I DREJTPËRDREJTË

që do të thotë kur individit për shkak të rrethanave personale ka qenë apo mund të jetë **në situata të njëjta ose të ngjashme i trajtuar në mënyrë më të ulët se sa një tjetër.**

(Si shembull mund të marrim një shpallje për punësim, në të cilën theksohet se individët me karakteristikat e sipërpërmendura nuk mund të punësohen, apo tjetër shembull: një shkollë e përcaktuar të pranonte vetëm ata nxënës që i përkasin një kombi të caktuar).

2. DISKRIMINIMI JO I DREJTPËRDREJTË

që do të thotë se për shkak **të pamjes së jashtme, të përcaktimit neutral, kriterit apo sjelljes** në situata dhe kushte të njëjta apo të ngjashme e venë **individin, me rrethana të caktuara personale në një pozitë më të ulët se një individ tjetër,** përkundrazi nuk do të ishte kështu, nëse këto përcaktime, kritere ose sjellje do t'i justifikonte objektivisht ndonjë synim ligjor dhe nëse do të ishin mënyra të duhura dhe të përshtatshme për arritjen e një qëllimi të caktuar. (Shembull i diskriminimit jo të drejtpërdrejtë do të ishte, nëse kandidatit, i cili kërkon punësim, t'i vihet kusht njohja e një gjuhe që nuk është e domosdoshme për këtë vend pune. Si pasojë e humbasin mundësinë e punësimit të gjithë ata që kanë gjuhë amtare tjetër prej asaj të kërkuarës).

3. UDHËZIMET

që e kanë kuptimin e pikave të sipërpërmendura. (Shembull: drejtori urdhëron nëpunësin e vet që ta arrijë diskriminimin në mënyrë që të mos e punësojë dikë vetëm për shkak të kombësisë së tij/saj, edhe pse i plotëson të gjitha kushtet e vëna).

4. PËRNDJEKJET

e ndryshme. Këto janë **sjellje të padëshiruara** që bazohen në çdo lloj rrethane personale, që krijojnë një mjedis të frikshëm, të urreyeshëm, nënvlerësues, të turpshëm ose fyes për personin e gjithashtu **fyejnë dinjitetin e tij/saj**. (Shembull: përhapja e shpifjeve me qëllim që të ulin poshtë bashkëpunëtorin/en, fyerje me fjalë poshtëruese për bashkëpunëtorin/en, shaka në llogari të grupeve fetare apo etnike, dhunë fizike ose trembje me dhunë, mosrespektimi i ndjenjave të njerëzve, të cilët janë objekt shakaje ose ofendimi, etj.).

5. VIKTIMIZIMI

është vënia e personit të diskriminuar para pasojave të ulëta për shkak të reagimit të tij/saj. (Shembull: atëherë kur me bashkëpunëtorët apo nëpunësit sillësh në mënyrë të ulët vetëm për shkak se janë ndjerë të diskriminuar dhe këtë gjë e kanë thënë haptas, nëse mbështesin një bashkëpunëtor tjetër që është ankuar, etj.).




Në rast të shkeljes së rregullave kundër diskriminimit, personat e diskriminuar, në bazë të ZUNEO- s, mund të kërkojnë **shqyrtimin e kësaj shkeljeje nëpërmjet procedurave gjyqësore dhe administrative**, gjithashtu edhe para **organeve të tjera kompetente** me kushte të caktuara në mënyrë ligjore dhe kanë **të drejtë ndaj dëmshpërblimit sipas rregullave të përgjithshme të drejtësisë civile**.¹

Në procedurën e zbatimit të të drejtave tek viktimat ka rëndësi **specifika, e cila bazohet tek faktet**, dhe kjo do të thotë se **personi i diskriminuar e vërteton diskriminimin me fakte**, të cilat e justifikojnë **dyshimin** se ka qenë i **shkelur rregulli i diskriminimit**. Duhet që **shkelësi i dyshuar të argumentojë** se në rastin që shqyrtohet **nuk ka shkelur rregullat** apo parimet e trajtimit të barazisë dhe rregullat **e diskriminimit**. Të sipërpërmendurat nuk vlejné për procedurat penale.

Për zgjidhjen e rasteve, ku dyshohet se janë shkelur rregullat e diskriminimit, në Zyrën për Mundësi të Barabarta, funksionon organi i Avokatit të Popullit për të drejtat e njeriut. Procedura e shqyrtimit para Avokatit të Popullit është joformale dhe falas.

¹ Vlerësim më i qartë i shqyrtimit do të mund të jepet atëherë kur do të jenë të njohura përfundimet e procedurave të para përpara Avokatit të Popullit. E njëjta vlen edhe për zbatimin e të drejtave të viktimave të diskriminimit në procedurat e tjera, sepse deri tani në Slloveni ky drejtim nuk ka qenë shumë i praktikuar.





PROCEDURA e SHQYRTIMIT para avokatit të popullit

1. Viktima e diskriminuar mund të bëjë **padinë** për fillimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, e cila duhet të përmbajë mjaft **argumente**. Afati për dhënien e padisë është **1 vit pas ndodhjes së rastit**. Paditë e dhëna **më vonë** mund të shqyrtohen **vetëm në raste të veçanta**.


2) Shqyrtimi rrjedh me **shkrim**, nga të dyja anët, si ajo paditëse edhe ajo e pandehur, mund të kërkohen sqarimet përkatëse brenda një afati të caktuar. Ato **mund** të ftohen në **bashkëbisedim**.

3) **Në rast të përdjekjes, Avokati i Popullit merr të drejtë, qëme anët të thirrjes me shkresë, të mbrojë personin e diskriminuar, në atë mënyrë, që të eliminohen pasojat e diskriminimit.**

4) Procedura **mbyllet me përfundim me shkrim**, në të cilën Avokati i Popullit përmend rezultatin e procedurës dhe vlerëson rrethanat e rastit të shqyrtuar me përfundimin se ekziston shkelja e ligjit për diskriminimin dhe për këtë njofton që të dyja palët. Në përfundimin e nxjerrë **tërheq vëmendjen për anomalitë** e gjetura dhe **këshillon** se në çfarë mënyre ta gjejnë **zgjidhjen** dhe e **fton të pandehurin/ën** që brenda **një afati të caktuar** të njoftojë organet për masat e marra për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Nëse i/e pandehuri/a nuk merr masa për përmirësimin e këtij gabimi në përputhje me këshillat e Avokatit të Popullit ose

nëse në afatin e caktuar nuk njofton për masat e marra, atëherë Avokati i Popullit nxjerr përfundimin se në këtë rast kemi të bëjmë me diskriminim dhe për këtë çështje e dërgon mendimin e tij me shkrim tek inspektorati përkatës. Inspektorati është i detyruar që ta shqyrtojë përfundimin e nxjerrë nga Avokati i Popullit dhe të sugjerojë shqyrtimin e kësaj çështjeje në organet përkatëse për shkak të shkeljes së ligjit, megjithëse ai vetë vlerëson se në këtë çështje kemi të bëjmë me shenja diskriminimi. Kjo do të thotë gjykim shtesë i inspektoratit përkrah gjyqimit të Avokati i Popullit, por viktimës nuk i garanton se do të jetë i mendimit të njëjtë edhe i/e pandehuri/a.



BARAZIA

Zyra e Pushtetit të RS-së për Barazi
Avokati i Popullit
Tržaška 19/a
1000 Lubjanë

Posta elektronike: uem@gov.si
Telefon: 01/4788460
Faks: 01/4788471

Institucioni i sigurimeve e i të drejtave të njeriut dhe lirive të tjera themelore dhe **Avokati i Popullit për të drejtat e njeriut** kanë marrëdhënie me organet e shtetit, organet vetëqeverisëse vendore dhe mbartësit e përfaqësimeve publike. Procedura para Avokatit të Popullit për të drejtat e njeriut është joformale dhe falas.

AVOKATI I POPULLIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Avokati i Popullit për të drejtat e njeriut në RS
Dunajska cesta 56 (4. nadstropje)
1109 Lubjanë

Telefon: 01/4750050
Telefon falas: 080 15 30

Faks: 01/475 00 40

Posta elektronike: info@varuh-rs.si

Orari zyrtar: e hënë - e enjte, nga ora 09:00 deri në orën 15:30

E premte, nga ora 09:00 deri në orën 14:00

Në kuadër të Bashkimit Evropian funksionon organi i Avokatit të Popullit për të drejtat e njeriut, i cili heton akuzat për shkak të mosfunksionimit apo keqpërdorimit të administratës kush-tetuese dhe trupave të Bashkimit Evropian.

AVOKATI EVROPIAN I POPULLIT

TË DREJTAT E NJERIUT

The European Ombudsperson

1, av. du President Robert Schuman

B. P.403

FR-67001 Strasbourg Cedex

Telefon: +33 (0) 3 88 17 90 62

Faks: +33 (0) 3 88 17 90 62

euro-ombudsman@europarl.eu.int

<http://www.euro-ombudsman.eu.int>


Viktimat e diskriminimit mund t'i shfrytëzojnë të drejtat e tyre në bazë të legjislaturës në fuqi edhe me anë të procedurave të tjera, mes të cilave mund të përmendim:

Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit është përcaktuar në nenin e 6-të të Ligjit për Marrëdhëniet Punësore që thotë se nuk lejohehet që **kandidati për punësim ose punëtorit në kohën e marrëdhënieve punësore dhe në lidhje me shkëputjen e kontratës së punës** të vendoset në pozitë jo të barabartë për shkak të seksit, racës, ngjyrës së lëkurës, moshës, gjendjes shëndetësore apo invaliditetit, bindjes politike, fetare apo tjetër, marrjes pjesë në sindikatë, prejardhjes sociale apo kombëtare, statusit familjar, gjendjes pasurore, drejtimit seksual apo rrethanave të tjera. Në rast të shkeljes së kontratës, viktimat mund të fusë në fuqi të drejtat e veta para gjyqit të punës, dhe për këtë incident mund të ndërhyjë edhe inspektorati i punës.

Viktima, në rast diskriminimi, **mund të kërkojë dëmshpërblim** për dëmin e shkaktuar **material apo jomaterial**. Dëmshpërblimin mund ta kërkojë nëpërmjet procesit juridik, ku nevojitet që të argumentojë gjendjen për dëmshpërblim, pra dëmin, faktin e palejueshëm dëmtues dhe lidhjen mes tyre, ndërkohë kur në lidhje me fajin Ligji i Detyrimit përcakton që faji pandehet dhe shkaktuesi i tij duhet të argumentojë që faji nuk ka vlerë (të argumentojë që nuk është fajtor).

Në degën e drejtësisë penale, libri i ligjeve **penale** i klasifikon





veprimet penale dhe zhdukja e tyre është kuptimi themelor i luftën kundër diskriminimit. Në **nenin 141** është klasifikuar **veprimi penal i shkeljes së barazisë**. Gjithashtu dënohet ai/ajo i/e cili/a dëbon ose nuk pranon individin apo organizatën e caktuar, për shkak të përkrahjes së vet për barazinë e njerëzve. Në **nenin 300** është përcaktuar **veprimi penal për nxitjen e urrejtjes, përçarjes apo padurimit, të cilat kanë themel në parimet penale të barazisë**. I/e dëmtuari/a, sipas procedurës penale, ka të drejtë që të kërkojë dëmshpërblim në përputhje me ligjin.

Për ndalimin e diskriminimit mund t'iu drejtohem edhe **procedurave administrative**, në bazë të të cilave administrata dhe organet e tjera shtetërore, organet vetëqeverisëse të bashkive vendore dhe mbartësit e autorizimeve publike, për çështjet zyrtare drejtpërdrejt rregullzbatuese, vendosin për të drejtat e detyrimit e personave juridikë. Pas mbylljes së çështjes, nëse viktimia nuk pajtohet me vendimin, ka të drejtë që **të padisë** përsëri. Gjykata gjykon edhe një herë vendimin e marrë nga organet administrative.

Viktima e diskriminimit, për përkryerjen e kushteve të caktuara, mund të drejtohet edhe tek **gjykata kushtetuese**. Ajo, mes të tjerash, vendos edhe **për vlerësimin kushtetues, rregullat ligjore dhe aktet e përgjithshme, të ndërmarra për autorizime publike dhe për ankesat kushtetuese** për shkak të shkeljes të shkeljes

të të drejtave të njeriut dhe lirive të veta themelore me akte të veçanta përkatëse. Ankesa kushtetuese, në bazë të kushteve që i përcakton ligji, mund të bëjë kushdo që mendon **se me anë të ndonjë akti të veçantë të organit shtetëror, organeve të bashkive vendore apo mbartësve të autorizimeve publike, ka qenë e shkelur e drejta e vet njerëzore.**


Tek mësimi i disa rrugëve juridike, për zbatimin e të drejtave të viktimave të diskriminimit, duhet theksuar që kemi ardhur në përfundimin se deri tani në Slloveni nuk kemi pasur shumë procese që do të na tregonin se si funksionon ky sistem praktikisht. Vijmë në përfundimin se vlera thelbësore e kushtetutës dhe e akteve të përcaktimeve të shkruara në të janë të varura para së gjithash nga ajo se si do t'i përdorë, përkthejë dhe vëre në zbatim gjykata, administrata shtetërore dhe mbarë publiku slloven. Përpara se të gjenden çështje të tilla në procedurë, është detyrimi i banorëve të Sllovenisë që me të gjitha forcat e tyre ta parandalojnë pabarazinë dhe diskriminimin në jetën e përgjithshme.

NORMAT NDËRKOMBËTARE QË NDAJOJNË DISKRIMINIMIN

ORGANIZATA
E KOMBEVE TË
BASHKUARA

Me nënshkrimin e akteve kushtetuese të Kombeve të Bashkuara (OKB), në vitin 1945, kombet që lidhën kontratë në emër të drejtat e njeriut. Në pikën 1 të nenit DT, mes të tjerash është përmendur se **qëllimi i aktit kushtetues (DT), është realizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe me zhvillimin e tij do të nxitet respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të tij, pa marrë parasysh racën, seksin, gjuhën apo fenë.** Të drejtat e njeriut në dhjetëvjeçarët e kaluar nuk arritën një zhvillim të efektshëm. Dokumenti themelor në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në normat botërore, është Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut e vitit 1948, që kishte karakter deklarues. Kjo deklaratë përcakton listën e të drejtave të njeriut, si ideal i përbashkët, dhe çdokush ka të drejtë t'i gëzojë ato pa marrë parasysh racën, ngjyrën e lëkurës, seksin, gjuhën, fenë, bindjet politike apo të tjera, kombësinë apo përkatësinë sociale, pasurinë, lindjen apo ndonjë rrethanë tjetër të tyre. Deklarata nxiti edhe formimin e dokumenteve të tjera në drejtim botëroro-rajonal, gjithashtu për mbrojtjen kundër diskriminimit. Disa nga më të rëndësishmet, që mund të rreshtojmë, janë:

1. Konventa e Kombeve të Bashkuara për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit,
2. Pakti ndërkombëtar për të drejtat shtetërore dhe politike me anë të dy protokolleve fakultative,
3. Konventa ndërkombëtare për nënshtrimin dhe ndëshkimin e krimit të aparteidit,
4. Konventa e UNESCO-s kundër diskriminimit në arsimim, dhe



5. Konventa ndërkombëtare e organizatës së punës nr. 111 për ndalimin e diskriminimit në punësim dhe profesion.

Në bazë të kryerreshtit të parë të nenit 1 të Konventës së OKB-së për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit **ndalohe**t diskriminimi racor, **çdo lloj dallimi, kufizimi apo dhënie përparësie** në themel të *racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes etnike apo shtetërore*, i cili **ka për qëllim ose vepron për të mposhtur çdo njeri ose t'ia marrë** të drejtën e **gëzimit të barazisë, gëzimin dhe realizimin e të drejtave të njeriut** dhe liritë themelore, drejtimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe në çdo fushë të jetës publike.


Në bazë të disa akteve ndërkombëtare, individët kanë mundësi që, për përbushjen e kushteve të caktuara, të drejtohen në organet jashtë Sllovenisë për përdorimin e të drejtave të tyre, mes të cilave janë:

1. **Të dhënat** e personave të veçantë ose të grupeve të njerëzve, të cilat mendojnë se janë **viktima të shkeljes së çdo lloj të drejte nga pakti për të drejtat politike dhe shtetërore, mund të shqyrtohen. Këto të dhëna dorëzohen tek Këshilli i të Drejtave të Njeriut**, i cili heton nëse kanë qenë të shfrytëzuara të gjitha rrugët juridike në shtetin e tyre. Këshilli duhet që mendimin e tij t'ia lajmërojë anëtarëve të OKB-së dhe palës së

dëmtuar. (shiko Paktin Ndërkombëtar të Protokolleve Fakultative)

2. **Të dhënat** e personave të veçantë ose grupeve të njerëzve, të cilët mendojnë se janë shkelur marrëveshjet që janë nënshkruar për të drejtat e njeriut, të përcaktuara në Konventën e OKB-së për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit racor, mund të shqyrtohen. Këto të dhëna i dorëzohen këshillit për zhdukjen e diskriminimit racor. Këshilli duhet që këshillat dhe propozimet, që mund t'i ketë, t'ia dërgojë shtetit të dëmtuar dhe lutësit, që ka bërë peticionin. (shiko nenin 14 të konventës). RS-ja e lejoj përcjelljen e këtyre të dhënave me kusht që këshillit të mos i lejohet shqyrtimi i këtyre të dhënave, përveç nëse është i bindur se e njëjta çështje nuk ka qenë e shqyrtuar, apo që nuk ka qenë e trajtuar në procedurën e dytë të hetimeve ndërkombëtare.

Të dhënat e përmendura në pikën 1 dhe 2 mund t'i adresoni në:



Petitions Team

Office of the High Commissioner for Human Rights
United Nations Office at Geneva
1211 Geneva 10, Switzerland

Faks: +41 (0) 22 9179022 (posaçërisht për raste urgjente)

Posta elektronike: tb-petitions.hehr@unog.ch

Përkrah të sipërpërmendurave u pranuan edhe shumë dokumente me peshë politike, me anën e të cilave mundohen të ndreqen dukuritë e diskriminimit dhe të padurimit, për shkak të fesë ose bindjeve të tjera, padurimit racor, të drejtat e anëtarëve të kombeve etnike, pakicave fetare me gjuhë të ndryshme, etj.




KËSHILLI EVROPIAN

Këshilli Evropian, si organizatë ndërkombëtare rajonale, ka arritur suksese të mëdha në formimin dhe zbatimin e standardeve për të drejtat e njeriut. Në dokumentin themelor të Këshillit Evropian - Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore – shtetet, që kanë nënshkruar, i kanë vendosur vetes për detyrë që t’iu garantojnë të gjithëve gëzimin e të drejtave të pranuar në konventë, pa dallim race, seksi, ngjyre të lëkurës, bindjeje politike apo tjetër, kombësie, prejardhjeje sociale e kombëtare, pronësie, lindjeje apo ndonjë rrethane tjetër. Megjithëse shkruhet dhe duket shumë premtuese, është e nevojshme të përmendim se drejtësia për trajtimin e barabartë ende nuk funksionon në mënyre të pavarur, por në lidhje me të drejtat e tjera që bazohen në këtë konventë.

Kushti kryesor për fillimin e procesit para Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut është shfrytëzimi i rrugëve të brendshme juridike, brenda një afati 6-mujor që nga dita kur ka qenë pranuar vendimi përfundimtar sipas ligjeve të brendshme. Pas vënies në fuqi të Protokollit nr. 12 në konventën e sipërpërmendur, shtete të veçanta pranojnë parandalimin e diskriminimit dhe funksionimin e tij të pavarur. Sllovenia e ka nënshkruar këtë Protokoll, por nuk e ka vënë ende në fuqi.

Në bazë të kryerreshtit të parë në nenin 1 të protokollit nr. 12 të kësaj konvente nënvizohet:

Gëzimi i çdo të drejte, e cila parashikohet me ligj, garantohet pa asnjë lloj diskriminimi në çdo lloj baze *sic janë: seksi, raca, ngjyra, bindja politike apo tjetër, kombësia, prejardhja sociale, lid-*



hja me pakicat kombëtare, pronësia, lindja apo ndonjë status tjetër.

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT


European Court of Human Rights
Council of Europe
67075 Strasbourg-Cedex
France

Telefon: +33 (0) 3 88412018
Faks: +33 (0) 3 88412730

Informatat e vlefshme shtesë:

IDC Këshilli Evropian

Rimska 16, 1000 Lubjanë
Telefon: +386 (0) 1/42 14 300
Faks: +383 (0) 1/42 14 305



BASHKIMI EVROPIAN

Në të kaluarën BE-ja, para së gjithash, ndaloi të gjitha format e diskriminimit, të cilat e kishin themelin në dallimin mes shtetasve të shteteve anëtare apo të sekseve. Me pranimin e Marrëveshjes së Amsterdimit dhe futjen e nenit 13 në të, lufta kundër diskriminimit u zgjerua edhe në drejtime të tjera. Kështu u **bë pjesë e luftës kundër diskriminimit** jo vetëm **dallimi ndërmjet kombësive apo seksit, por edhe ai në bazë të racës, fesë, invaliditetit, moshës apo drejtimit seksual.**

Në bazë të nenit të lartpërmendur, Këshilli i BE-së pranoi në vitin 2000 paketën ligjore, me qëllim parandalimin e diskriminimit dhe zbatimin e standardeve të reja për respektimin e plotë të të drejtave të njeriut në BE.

Në Marrëveshjen për Kushtetutën Evropiane, e cila është tashmë në proces ratifikimi, në luftën kundër diskriminimit është bërë edhe një hap përpara, sepse dihet se në këtë dokument diskriminimi është rreptësisht i ndaluar.

Neni 11-81. Ndalohet diskriminimi

(1) Ndalohet çdo lloj diskriminimi në bazë të seksit, racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes etnike apo sociale, karakteristikave gjenitale, përkatësisë së pakicave kombëtare, pasurisë, lindjes, invaliditetit, moshës apo drejtimit seksual.

(2) Në fushën e zbatimit të kushtetutës është i ndaluar çdo lloj diskriminimi në bazë të shtetësisë, pa marrë parasysh përcaktime të veçanta.

UDHËZUESIT

Dokumentet më të rëndësishme nga paketa e udhëzuesve për luftën kundër diskriminimit janë këto në vazhdim: **Udhëzuesi për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të njerëzve pa marrë parasysh racën apo kombësinë (2000/43/ES) dhe Udhëzuesi i BE-së për trajtimin e njëjtë në punësim dhe punë (2000/78/ES).**

Qëllimi i përgjithshëm i këtyre dy udhëzuesve është formimi i një njësie minimale standarde për shmangien e diskriminimit në të gjitha vendet e BE-së. Gjithashtu, ato iu mundësojnë shteteve anëtare që të pranojnë shmangien e diskriminimit në mënyrë më të lehtësuar legjislative, por shtetet duhet që të arrijnë të paktën standardin minimal që e përcaktojnë këto dy udhëzues.

Udhëzuesit **mbrojnë nga diskriminimi çdo njeri që banon dhe punon në BE**, pra jo vetëm shtetasit e shteteve anëtare, por edhe të shteteve të tjera të Evropës. Këto udhëzues kanë të përbashkët parandalimin e diskriminimit, që bazohet në preardhjen racore apo etnike, fenë, bindjen, invaliditetin, moshën ose drejtimin seksual të individit **në fushat e mëposhtme:**

- **të drejtat ndaj punësimit**, vetëpunësimit, punës zëjtare private dhe mundësisë për përparim,
- të drejtat **ndaj zgjedhjes së profesionit**, arsimimit në të gjitha fushat, si edhe të drejtat ndaj punës praktike, praktikimit,
- **punësimit**, kushteve të punës, ndërprerjes nga ajo, rrogës, si edhe
- **përfshirjes së tyre në sindikata** dhe bashkime profe-

sionale dhe si pasojë ndaj dobive që rrjedhin nga ato.

Shtesë tek udhëzuesit për barazinë racore është edhe lufta kundër diskriminimit në fushat e mëposhtme:

- drejtimi i **mbrojtjes sociale** bashkë me sigurimin social dhe atë shëndetësor,
- drejtimi i **përkrahjes sociale**,
- **arsimit**,
- **të drejtës ndaj të mirave materiale dhe punëve private**, që duhet t'i mundësohen publikut.

Për të njohur lehtë shenjat e diskriminimit, udhëzuesit kanë përcaktuar në mënyrë të përpiktë se çfarë është diskriminimi dhe se në çfarë formash është i ndaluar.

Pika "a" e kryerreshtit të dytë të nenit 2 të udhëzuesit 2000/43/ES përcakton që si **diskriminim i drejtpërdrejtë** llogaritet ai, në të cilin një person trajtohet në mënyrë më të ulët se sa duhet të trajtohet, nga një person tjetër me të njëjtën pozitë, në bazë të racës apo kombësisë.

Pika "b" e kryerreshtit të dytë të nenit 2 të udhëzuesit 2000/43/EC përcakton që si **diskriminim jo të drejtpërdrejtë** llogaritim, nëse përcaktimi në pamje neutrale, norma ose praktika, e vendos personin e ndonjë race apo kombësie tjetër në pozitë më të ulët, të veçantë në krahasim me personat e tjerë. Por kjo nuk do të thotë që është diskriminim, nëse këtë përcaktim normativ apo praktikë e



justifikon një qëllim ligjor dhe atëherë kur rrugët për arritjen e këtij


Kryerreshti i tretë i nenit 2 të udhëzuesit 2000/43/EC përcakton se

përndjekja llogaritet si diskriminim atëherë kur vjen deri në sjellje të padëshiruara, në lidhje me racën, kombësinë dhe si pasojë nënvlerësimi i personit dhe krijimi i një mjedisi të frikshëm, urryes, të turpshëm, nënvlerësues apo fyes.


Udhëzimi për sjellje tendencioze me personat, në baze të fesë ose shtetësisë, llogaritet si diskriminim bazuar në kryerreshtin e katërt të nenit 2 të udhëzuesit 2000/43/ES.

Në përputhje me nenin 16 të udhëzuesit 2000/43/ES është i ndaluar **viktimizimi**. Me qëllim zbatimin e parimit të shqyrtimit të barazisë, mund të hapet procedurë ndaj çdo lloj trajtimi të ulët me pasoja të dëmshme.

Që të ndalohet diskriminimi në mënyrë më të suksesshme, Udhëzuesi i Barazisë Racore kërkon nga shtetet anëtare formimin e organeve të pavarura që do t'iu ndihmojnë individëve të caktuar, të cilët janë përballur me diskriminimin për shkak të racës apo prejardhjes së tyre etnike. Pushtetet duhet që t'i pajisin organet e përmendura me dokumentet përkatëse, që në mënyrë të pavarur dhe të lirë të hetojnë në drejtimin e diskriminimit, lirisht të shpallin të dhëna me qëllim që të përmirësojnë kuptimin e problemeve, të gjejnë zgjidhje për ta dhe t'iu garantojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.



Këto dy udhëzues sjellin të reja në pikëpamjen e argumentimit të sjelljes diskriminuese, pra diskriminimi ekziston. Shtetet anëtare duhet të marrin masa të tilla që **të pandehurin/ën** ta venë para faktit, e ai/ajo duhet të **vërtetojë se nuk e ka shkelur parimin ligjor të trajtimit të njëjtë të njerëzve**. Në rast se persona të caktuar pohojnë se janë viktime të diskriminimit, **paraqesin**, në gjykatë apo në organe të tjera kompetente, **fakte**, në bazë të të cilave mund të dyshohet se ka ardhur deri tek **diskriminimi** i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë. Të sipërpërmendurat nuk vlejnë tek procedurat penale.



PROGRAMI KOLEKTIV I VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR DISKRIMINIMIT


Në të kaluarën është dukur qartë, se vetëm formulimi dhe pranimi me çdo kusht i legjislaturës, nuk është i mjaftueshëm për arritjen e qëllimeve për të cilat ka qenë e pranuar ajo. Për këtë arsye Këshilli i BE-së, në nëntor të vitit 2000 ndërmoi Programin e Veprimit të Bashkimit Evropian për luftën kundër diskriminimit (2000-2006), me qëllim që të nxjerrë në pah masat e marra për luftën e diskriminimit të drejtpërdrejtë apo atij jo të drejtpërdrejtë, që bazohen në racën, përkatësinë etnike, bindjet fetare, politike apo të tjera, invaliditetin, moshën ose veçantitë seksuale.

Programi i Veprimit kështu mbështet të gjitha mendimet dhe planet në drejtim të BE-së dhe shteteve anëtare, të cilat e mbështesin këtë luftë. Kujdes i veçantë i kushtohet qëllimeve të mëposhtme:



- përmirësimit të kuptimit dhe njohjes thelbësore të diskriminimit,
- Mbështetjes së atyre veprimtarive, të cilat do të shmangin me sukses dhe me efekt diskriminimin, veçanërisht ndërlidhjet dhe shkëmbimet e informatave dhe përvojave në kuadër të BE-së, dhe
- Me ndihmën e aksioneve të organizuara t'i ngrihet ndërgjegjja publikut dhe të përhapen vlerat dhe virtytet që e parandalojnë diskriminimin.

Në këto qëllime, për kuptimin e pyetjeve në lidhje me diskriminimin, gjejmë një spektër të plotë të veprimtarive të ndryshme, që nga mbikëqyrja dhe analiza mbi zbatimin e të dy udhëzuesve, deri tek përgatitjet e botimeve të ndryshme lidhur me pyetjet





për diskriminimin. Qëllimi i këtyre veprimtarive është marrja e sa më shumë informatave për gjendjen në këtë fushë në të gjithë BE-në, si dhe formimi i politikës në të ardhmen për këtë drejtim. Qëllimi tjetër, të cilit i kushtohet vëmendje shtesë në këtë Program Veprimi, është nxitja e dialogut e formimi i rrjeteve telefonike-internetare, dhe bashkëpunimi në kuadër të BE-së. Qëllimi thelbësor i këtij bashkëpunimi është shkëmbimi i njohurive, informatave dhe përvojave mes aktorëve të ndryshëm që do të mundësojnë formimin e politikave më cilësore për luftën kundër diskriminimit. Për zbatimin e efektshëm të legjislaturës së re, duhet që banorët e BE-së të informohen në norma të bollshme. Përgatitësit e Planit të Veprimit e kanë marrë parasysh këtë në veçanti dhe për këtë arsye janë planifikuar plane të shumta, aksione informuese me gjerësi dhe përmbajtje të ndryshme. Zbatimin e këtij programi e mbikëqyr Komisioni Programor i BE-së, i cili është i përbërë nga përfaqësues të shteteve anëtare dhe Komisionit të BE-së, qëllimi i të cilit është që të kujdeset që veprimtaritë të zhvillohen në përputhje me Planin e Veprimit.



paraqitja e iscomet-it, mbartës dhe koordinator i projektit: edukim dhe arsimim për Luftën kundër diskriminimit në sLloveni

Mbartësi dhe koordinatori i projektit, ISCOMET - Instituti i Studimeve Etniko-Rajonale, paraqet një kornizë juridike për funksionimin e organizatave joqeveritare ndërkombëtare me emrin ISCOMET - International Scientific Conference Minorities for Europe Tomorrow/ISCOMET - Konferenca Shkencore Ndërkombëtare e Pakicave për Evropën e nesërme. ICOMET-i i ka lëshuar rrënjët e veta në vitin 1989 atëherë kur grupi i specialistëve në mbështetje të Këshillit Evropian pranoi statusin dhe programin e punës ISCOMET.

ISCOMET-i që nga viti 1992 gëzon statusin këshillimor në Këshillin e Evropës. Në vitin 1998 arriti që të bëhet njëra prej 35 organizatave joqeveritare, që kanë të drejtë të hedhin akuza kolektive, në rast të shkeljes së ligjit social evropian.

Sot është ISCOMET-i, një organizatë e gjerë ndërkombëtare, që lidh rreth 250 grupe individuale dhe kolektive, mes të cilëve janë specialistë të njohur, profesorë, veprimtarë funksionarë, që vijnë nga shtetet e tjera. Ata i bashkon detyra për ruajtjen e qetësisë, zhvillimit demokratik, denjësisë njerëzore dhe marrëdhënies shoqërore midis shteteve, popujve dhe rajoneve Evropiane.

ISCOMET-i bashkërendon dhe zbaton projekte të ndryshme ndërkombëtare, organizon mbledhje shkencore dhe speciale ndërkombëtare, nxit shkëmbimin e njohurive dhe përvojave, mbështet zbulimet në këtë fushë dhe të gjitha veprimtaritë qeveritare e joqeveritare të organizuara, të cilat synojnë arritjen e qëllimeve të ngjashme.

ISCOMET-i i kushton vëmendje të veçantë organizatave të



shumta ndërkombëtare, takimeve profesionale, konferencave shkencore, tryezave të rrumbullakëta, seminareve të ndryshme, etj. Deri më tani, ISCOMET-i ka organizuar 20 konferenca ndërkombëtare bashkë-evropiane, të cilat kanë shqyrtuar ndryshimet e përgjithshme aktuale politiko-shoqërore në Evropë. Mes konferencave më të rëndësishme përmendim ato të Bernës, Odesës, Timishoarës, Kopenhagës, Mariborit dhe Shën Petërburgut.

Në fund të viteve nëntëdhjetë u shfaq edhe rrjeti ISCOMET për demokracinë, të drejtat e njeriut, mbrojtjen e pakicave, bashkëpunimin dhe zhvillimin në Evropën juglindore. Anëtarët e rrjetit ISCOMET i kanë kushtuar vëmendje të veçantë nxitjes së ndihmesës së kishave dhe bashkimeve të tjera fetare në Evropën juglindore, dhënien e ndihmesës së tyre në bashkim, demokraci, respektimin e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, e gjithashtu në marrëveshje dhe zhvillim. Këto qëllime të projektit ndërkombëtar u quajtën *Mariborska pobuda*, apo kushtrimi Mariboras në shqip. Brenda këtij projekti, ISCOMET-i mbajti konferenca me jehonë në Beograd, Timishoara, Maribor dhe Kishinjevë. Presidentin e ISCOMET-it në Maribor, e ftuan sivjet që të raportojë për rezultatet e arritura të këtij projekti në mbajtjen e ditëve të studimeve të Këshillit Evropian në Strasburg.

ISCOMET-i zhvillon edhe veprimtarinë e vet botuese dhe ka nxjerrë botime të shumta shkencore (E drejta ndaj të ndryshmes, Pozita e individit në ligjet ndërkombëtare, etj.), si edhe **ërmbledheje** (Rujata e ëndrrave, Feja dhe demokracia moldave

në gjuhën angleze, romane, etj.) Që nga viti 1995 është bërë edhe bashkëbotues i revistës Kontakti Rajonal, e cila i kushtohet shkëmbimeve të përvojave dhe ideve rajonale, bashkëpunimeve ndërkufitare, ruajtjes së pasurisë kulturore, rajonale dhe grupeve etnike, gjithashtu mbrojtjes së pakicave në Evropë.



adresa të DOBISHME NË INTERNET

ORGANIZATA E KOMBEVE TË BASHKUARA

<http://www.unog.ch/IntInstr/unistr.exe?language=en>

– Dokumente Universale

<http://www.unhchr.ch/html/menu2/6/cerd.htm>

– Komisioni për Zhdukjen e Diskriminimit Racor

<http://www.unhchr.ch/html/menu2/issrasis.htm>

– Komisari i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut

<http://www.unhchr.ch/html/racism/index.htm>

– Konferenca Botërore kundër Ksenofobisë dhe Formave të Tjera të Mostolerancës

KËSHILLI EVROPIAN

<http://www.coe.int/t/E/humanrights>

– Drejtoria e Përgjithshme e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut

<http://www.echr.coe.int/echr>

– Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut



BASHKIMI EVROPIAN

<http://www.stop-discrimination.info/>

– Bashkimin Evropian për Luftën kundër Diskriminimit

[http://www.europa.eu.int/comm/employment social/fundamenta/rights/index.en.htm](http://www.europa.eu.int/comm/employment_social/fundamenta/rights/index.en.htm)

– Mundësi të barabarta, jodiskriminim, shoqata civile

<http://www.eume.eu.int/eume/index.php>

– Qendra Evropiane për Mbikëqyrjen mbi Racizmin dhe Ksenofobinë (EUMO)

REPUBLIKA E SLLOVENISË

<http://www.dz-rs.si/>

– Këshilli Shtetëror i RS-së

<http://www.varuh.-rs.si/>

– Avokati i Popullit për të Drejtat e Njeriut në RS

<http://www.gov.si/uvs/>

– Zyra e Pushtetit të RS-së për Mundësi të Barabarta

<http://www.uem.rs.si/>

– Zyra e Pushtetit të RS-së për Shoqatat Fetare

<http://www.uvi.si/slo/vlada/naslovi/narodnosti/>

– Zyra e Pushtetit të RS-së për Popullsitë

<http://www.iscomet.org>

– Instituti i Studimeve Etniko-Rajonale



GRUPI PROJEKTUES

Anëtarët e grupit

ISCOMET - Instituti i Studimeve Etniko-Rajonale, Maribor, Slloveni
Fakulteti Juridik, Universiteti Evropian Viadrina, Frankfurt/O.,
Gjermani


Instituti Austriak për të Drejtat e Njeriut, Salzburg, Austri
Instituti Ekumenik, Fakulteti i Teologjisë Katolike, Universiteti i
Munstrunit, Gjermani

Fakulteti Juridik Erasmus, Universiteti i Roterdamit, Holandë
ECERS-Qendra Evropiane për Studimet Etniko-Rajonale-Sociale,
Universiteti i Mariborit, Slloveni



Koordinator

ISCOMET - Instituti i Studimeve Etniko-Rajonale
Maribor, Slloveni



DREJTIMI I PROJEKTIT

Koordinator

Prof. dr. Silvo Devetak, Drejtor i ISCOMET - Instituti i Studimeve Etniko-Rajonale
Maribor, Slloveni

Zëvendësi i koordinatorit

Prof. dr. Gerard Rowe, Fakulteti Juridik, Universiteti Evropian Viadrina
Frankfurt/O., Gjermani

Këshilli ndërkombëtar programor

Prof. dr. Thomas Bremer, Drejtor i Institutit Ekumenik, Universiteti i Munstrunit, Gjermani

Prof. dr. Sergej Flere, ISCOMET - Instituti i Studimeve Etniko-Rajonale, Maribor, Slloveni

Prof. dr. Wlfram Karl, Instituti Austriak i Studimeve për të Drejtat e Njeriut, Salzburg, Austri

Dr. Vera Klopçiq, Bashkëpunuese e jashtme e ISCOMET-it - Instituti i Studimeve Etniko-Rajonale, Maribor, Slloveni

Prof. dr. Math Northman, Fakulteti Juridik, Universiteti Erasmus, Rotterdam, Holandë

Administrimi i projektit

Dipl. Uni. Jasmina Klojçnik dhe Oec. Mag. Franc Mlinar

Kontaktet


ISCOMET - Instituti i Studimeve Etniko-Rajonale

H. Tomšičeva 4, SI-2000 Maribor, Slloveni

Telefon: +386 (0) 2/250 04 40, Faks: +386 (0) 2/250 04 41

Posta elektronike: iscomet@siol.net

www.iscomet.org





ISCOMET - Instituti i
Studimeve Etniko- Rajonale

Za raznolikost



Protiv diskriminaciji



PROGRAM I VEPRIMIT I
BASHKIMIT EVROPIAN
PËR LUFTËN KUNDËR
DISKRIMINIMIT

© C. 2005 Prof. Dr. Silvo Devetak, Gregor Pelikon, Mag. Franc Mlinar
A ju trajtojnë në mënyrë të barabartë, pa marrë parasysh se të çfarë kombësie jeni?

Botues:

ISCOMET - Instituti i Studimeve Etniko- Rajonale

Redaktor kryesor:

Prof. Dr. Silvo Devetak

Redaktor përgjegjës:

Mag. Franc Mlinar

Për botuesen:

Jasmina Klojçnik

Redaktori në slovenisht:

Tatjana Vučajnik

Përkthyer në shqip, boshnjakisht, kroatisht, italisht, hungarisht,

maqedonisht, gjermanisht dhe serbisht:

Agjencia e përkthimeve PSD, Lubjanë

Përkujdesja grafike:

Tanja Bončina

Përgatitja dhe shtypi:

Grafiti Studio, Maribor

Librin e bashkëfinancoi KOMISIONI EVROPIAN

Ky publicitet u perkrah nga bashkimi European ne përmbledhje te programit Aksionar per luften kunder diskriminimit (2001-2006).

Programi ka qene i pranuar me qellim zbatim te legjislatures se re anti-diskriminive te BE. Ky program gjashte-vjetor u ben thirrje te gjithe atyre, te cilet mund te japin kontributin e tyre per formimin politik dhe legjislativ anti-diskriminiv, ne menyre te pershtatshme dhe efektive ne zonen e BE-25, EFTE dhe shteteve kandidatate per pranimin ne Europe.

Programi aksionar ka 3 qellime kryesore , keto jane:

1. Permissimi i kuptimit te permbajtjeve ne lidhje me diskriminimin
2. Zhvillimi i aftesive per perballimin e suksesshem me diskriminimin
3. Venja ne dukje e vlerave, te cilat jane themel per luften kunder diskriminimit

Informatat shites ne disponim:

http://europa.eu.int/comm/employment_social/fundamental_rights/index.en.htm

permbajtja e e ketij publiciteti nuk shpreh, ne menyre urgjente, opinionin dhe pikpamjet e Komisionit Drejtoral Europeanper punesim dhe cheshtje sociale. Komisioni European apo cdo njeri , cdo person, qe punon ne emrin e tij, nuk ka përgjegjesi per perdorimin, qe mund te vijoje nga infomatat ne kete publicitet.